



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1414 Prot.

Tiranë, më 11.11 2019

VENDIM Nr. 245, datë 08.11.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 48, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 13, datë 08.11.2019, pasi shqyrtoi Raportin e sondazhit arkeologjik në kuadër të projektit "*GODINË POLIFUNKSIONALE 3-4-6 KATE ME 2 KATE NËNTOKË*", rruga "*Egnatia*", zona arkeologjike "*B*", Durrës – subjekti "*KASTRATI*" sh.p.k, realizuar nga individ i licencuar Z. Luan Përzhita,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e sondazhit arkeologjik në kuadër të projektit "*GODINË POLIFUNKSIONALE 3-4-6 KATE ME 2 KATE NËNTOKË*", rruga "*Egnatia*", zona arkeologjike "*B*", Durrës – subjekti "*KASTRATI*" sh.p.k, realizuar nga individ i licencuar Z. Luan Përzhita.
2. Subjekti "*KASTRATI*" sh.p.k. të vijojë procedurën e shqyrtimit dhe vendimmarrjes në organet përkatëse të qeverisjes vendore.
3. Pas paisjes me lejen përkatëse të lëshuar nga organet e qeverisjes vendore, punimet e gërmimit do të realizohen nën monitorimin ditor të subjektit të licencuar në arkeologji, në vijim të akt-marrëveshjes tre palëshe të lidhur më parë për këtë objekt.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al